



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 30, date 15/03/2001

**“PER
MIRATIMIN E KONTRATES MIDIS BASHKISE TIRANE DHE INSTITUTIT
TE SIGURIMEVE SH.A PER BLERJEN DHE MONTIMIN E SEMAFORËVE
NE QYTETIN E TIRANES”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim kontratën e lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Sh.a. në shumën prej 13.200.000 (trembëdhjetë milion e dyqind mijë) lekësh për blerjen dhe montimin e semaforëve në qytetin e Tiranës
2. Shuma e mësipërme e përfituar nga INSIG-u si dhe projekti bashkëngjitur të propozohet pranë Këshillit të Ministrave për zhvillimin e procedurës së Prokurimit të Drejtpërdrejtë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA